



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 1163 / Prot.  
11

Tiranë, më 13 .04 .2021

**PROTOKOLL**

**“LIDHUR ME MASAT ANTI-COVID 19**

**GJATË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DITËS SË VOTIMEVE”**

Bazuar në situatën e krijuar nga pandemia e COVID-19, dhe në Urdhërin Nr.156 datë 10.03.2020 “*Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit*” dhe me qëllim mbrojtjen e shëndetit të zgjedhësve dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin, kërkohet zbatimit i masave të mëposhtme, të parashikuara në këtë Protokoll.

**I. Veprimet parandaluese që duhet të ndërmarrin punonjësit e zgjedhjeve dhe votuesit:**

- Qëndroni në shtëpi nëse keni ethe, simptoma të frymëmarrjes ose mendoni se jeni i sëmurë.
- Personat e konfirmuar COVID-19 pozitiv, duhet të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga MSHMS në protokollat përkatëse “*të zbatimit të karantinimit dhe izolimit të rasteve*”.

**II. Dita e votimit**

**A. Sallat ku do të jenë qendrat e votimit**

Sallat (qendrat votimit) dhe ambientet e brendshme të tyre ku do të votohet, duhet të organizohen nga ana e KQZ, në mënyrë të tillë që të respektohen masat kundër Covid- 19, si më poshtë

1. Salla rekomandohet të jenë në katin e parë, me sipërfaqe të konsiderueshme dhe të sigurojë ajrim të mjaftueshëm.
2. Salla duhet të jetë e pajisur me hyrje dhe dalje të veçanta për të mundësuar distancimin fizik të votuesve, në pamundësi të sigurimit të një salle me dy dalje, ajo të organizohet në mënyrë të tillë, që sigurojë distancim fizik të votuesve.
3. Në hyrje të çdo qendër votimi/sallë ku do të votohet, duhet të jenë vendosur shenjat dalluese në mënyrë të dukshme për orientimin e votuesve lidhur me masat kundër Covid-19.
4. Pranë hyrjes në sallën e votimit, të sigurohen shenjat dalluese për të orientuar votuesit të ruajnë distancën e nevojshme.
5. Në hyrje të qendrës së votimit, të vendoset dezinfektant për duart.
6. Çdo votues duhet të jetë i pajisur më maskë.
7. Kutitë e votimit duhet të vendosen të paktën 2 metra nga vendqëndrimi i anëtarëve të komisionit, po kështu dhe dhomat e fshehta.
8. Mjediset e brendshme të sallave (qendrës së votimit), duhet detyrimisht të dezinfektohen një ditë para procesit të votimit dhe më pas, në intervale të rregullta nga personeli sanitar i ngarkuar.
9. KQZ në bashkëpunim me komisionet përkatëse të qendrave të votimit duhet të caktojë një person përgjegjës i cili i pajisur me maskë, qëndron në hyrje të sallës së votimit, kontrollon zbatimin e masave anti-Covid 19 dhe orienton lëvizjen e votuesve sipas kërkesave të protokollit.
10. Qëndrat e votimit duhet të jenë të pajisura me tualet, ujë të rrjedhshëm, sapun të lëngshëm dhe letër higjienike. Tualeti duhet të pastrohen dhe dezinfektohen në mënyrë të rregullt.

## **B. Veprimet në qendrat e votimit**

### **► Vendosja e Komisionit të zgjedhjeve dhe vëzhguesve**

1. Ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV-të), si dhe vëzhguesit e akredituar, duhet të jenë të pajisur me maska

mbrojtëse gjatë gjithë kohës që janë në ambientet e sallës së votimit.

2. Përpara futjes në qendrën e votimit, anëtarët e KQV-ve dhe vëzhguesit, duhet deklarojnë (formular vetëdeklarimi) se nuk kanë temperaturë, ose shqetësime të tjera të lidhura me shenjat e COVID-19, të bëjnë dezinfektimin e duarve dhe të kenë vendosur maska.
3. Anëtarët e KQV-ve dhe vëzhguesit, duhet të ulen në vendet respektive duke ruajtur distancën fizike 1.5 metër nga njëri - tjetri.
4. Në sallën e votimit, nuk lejohet prania e më shumë votuesve se sa numri i dhomave të fshehta për votim, plus 2 (dy) persona që regjistrohen.
5. Dhomat e fshehta për votim duhet të ruajnë largësinë 1.5 metra nga njëra-tjetra.

#### ► Lëvizja e votuesve në qendrat e votimit

1. Për zhvillimin korrekt të procesit të votimit sipas masave anti-Covid, votuesit në qendrat e votimit duhet të lëvizin sipas përcaktimeve në këtë Protokoll.
2. Përpara qendrave të votimit nuk duhet të ketë grumbullime, personat që presin për të votuar duhet të ruajnë distancë fizike 1.5 metra njëri nga tjetri.
3. Gjatë kohës së pritjes, votuesit duhet detyrimisht që në hyrje të qendrës së votimit të dezinfektojnë duart dhe të mbajnë maskë.
4. Në hyrje të qendrës së votimit, caktohet nga Administratori i QV një punonjës i cili:
  - a. siguron që zgjedhësit në pritje për të votuar të qëndrojnë në rresht, të respektojnë distancën prej 1.5 metra.
  - b. u shpjegon votuesve për mënyrën e hyrjes dhe kufizon lëvizjet e panevojshme në qendrën e votimit.
  - c. Siguron që votuesit të jenë të pajisur me maskë
5. Votuesi, i cili përfundon procesin e votimit, duhet të vijoj te mbajë një distancë prej 1.5 m me votuesit që vijojnë procesin.
6. Votuesi pas procesit të votimit desinfekton duart.

► **Lëvizja e personave të tjerë në qendrat e votimit**

1. Çdo person tjetër, i autorizuar, që hyn në qendrën e votimit, detyrimisht duhet të plotësojë kërkesat e këtij Protokolli.

Ky Protokoll është i detyrueshëm për zbatim për të gjithë personat e përfshirë në ditën e votimeve.

**DREJTOR**

**Albana FICO**

